



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	02.06	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Ni Prot Br Prot Prot No	Shtojti e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINISHK	2793	2021	116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.389/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 06/05/2021 me numër A.nr.389/2021, e parashtruar nga ankuesi me adresë Veranda 3, Llamella 2, përballë Gjykatës, Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02/06/2021, mori këtë::

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.389/2021 e datës 06/05/2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitë "Shef i Sektorit të Arkivit", në Divizionin e Personelit dhe Administratës/Drejtoria për Shërbime të Përgjithshme, sipas kontratës së punës të datës 08.05.2014, i cili me datë 06.05.2021 ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mail-it zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 2245/2021 për realizimin e shujtës ditore, paga mujore ekuivalente me pagën e rregullt (shpërblim) në fund të vitit siç njihet si paga e trembëdhjetë si dhe shtesa në pagë për kualifikimin shkollorë të cilat kërkon ti realizoj për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021 konform Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.05.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 25.05.2021 Policia e Kosovës ka kthyer përgjigje në ankesën e ankuesit duke i bashkangjitur edhe shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 06.05.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimi i punës me numër të referencës 07/1-01SAP-P/2397; E-mail i datës 14.04.2021; Formulari për vlerësimin e punës (01.01-31.12.2018); Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020; Të dhënat për shpërblim jubilar; E-mail i datave 11.01.2021, 09.02.2021, 18.02.2021, 20.04.2021 dhe 22.04.2021; Kontrata e punës për kohë të pacaktuar, Diploma e datës 10.07.2008 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Filozofik, Diploma e datës 06.02.2017 e studimeve post diplomike e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik, Diploma e studimeve post diplomike e datës 30.04.2014 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me për realizimin e shujtës ditore, paga mujore ekuivalente me pagën e rregullt (shpërblim) në fund të vitit siç njihet si paga e trembëdhjetë si dhe shtesa në pagë për kualifikimin shkollorë të cilat kërkon ti realizoj për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të datës 14.11.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me realizimin e shujtës ditore, paga mujore ekuivalente me pagën e rregullt (shpërblim) në fund të vitit siç njihet si paga e trembëdhjetë si dhe shtesa në pagë për kualifikimin shkollorë të cilat kërkon ti realizoj për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të datës 14.11.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili ka pozitën "Shef i Sektorit të Arkivit", në Divizionin e Personelit dhe Administratës/Drejtoria për Shërbime të Përgjithshme, ka konstatuar se, duke u bazuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesit në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafin 5 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ankuesi është nëpunës civil i punësuar në Policinë e Kosovës, siç e përcakton kjo dispozitë: "5. Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjisllacionit përkatës në fuqi", që në kohën kur është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore që zbatohen për këtë fushë, respektivisht neni 4 paragrafi 1, të këtij ligji, i cili ka përjashtuar vetëm zyrtarët policor nga shërbimi civil në Policinë së Kosovës, mbi këtë bazë për veç tjerash të gjitha pagat nëpunësve civil dhe shtesat e nëpunësve civil të Policisë së Kosovës, rregullohen në bazë të nenit 4 paragrafi 1

dhe paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, të cilat ende kanë fuqi ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar nenin 44 paragrafi 2 si dhe duke u ndërlidhur me neni 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës mbi të cilën bazë juridike Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ka kompetencë për nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës për personelin policor dhe mbi të cilën bazë juridike ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018 por se që ky udhëzim do të duhej të jenë në harmoni me bazën ligjore që veç është e rregulluar një materie konkrete, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ekziston baza ligjore që e rregullon çështjen e pagave dhe shtesave të ndryshme të nëpunësve civil, siç është Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, rrjedhimisht dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, nuk mund të parashohin të drejta dhe beneficione ndryshe nga si është e rregulluar kjo çështje me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, prandaj pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe i cili është dekretuar nga Presidenti më datë 14/06/2010, e i cili është në fuqi edhe aktualisht, i cili në dispozitën e nenit 14 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij ligji, ka përcaktuar se: **"1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"**, si dhe neni 4 i Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera, mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, nuk ka marrë për bazë dispozitat e nenit 14, 15, 16, 17 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe neni 4 të Rregullores Nr.33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, sepse në dispozitat e këtij udhëzimi janë përfshirë edhe shtesa dhe beneficione tjera, dhe të cilat në raport me dispozitat e ligjit për paga Nr.03/L-147 dhe rregullores Nr.33/2012 që specifikisht rregullojnë këtë fushë nuk mund të kenë fuqi mbizotëruese për nëpunësit civil gjegjësit stafin civil në Policinë e Kosovës, andaj si i tillë Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës nuk është i zbatueshëm për këtë kategori të nëpunësve civil brenda institucionit të Policisë së Kosovës.

Lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, me datë 25.05.2021 Policia e Kosovës, ka dhënë përgjigje në ankesën e ankuesit me numër protokollit 2608/2021 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në të cilën është deklaruar se për

zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Policia e Kosovës ka bërë përpjekje për buxhet shtesë tek Ministria përgjegjëse me datë 24.10.2017, duke parashtruar kërkesë tek Ministria e Financave, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve sipas Qarkores me numër Ref.2018/02 për periudhën 2018/2020 dhe e cila kërkesë nuk është aprovuar nga Ministria e Financave. Në rastin konkret sipas këtij deklarimi zyrtarë të Policisë së Kosovës, është vërtetuar fakti se para se ta miratojë Udhëzimin Administrativ të datës 14.11.2018 Policia e Kosovës ka qenë dashtë të ketë një miratim nga Ministria e Financave konformë nenit 47 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës e që në këtë mënyrë përmbajtjen dhe formën e kësaj rregullore e bënë pa bazë ligjore sa i përket kësaj kategorie të nëpunësve civil.

Kolegji konstaton se nëse marrim për bazë dispozitën e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës respektivisht nenin 1 ku shprehimisht thuhet: *"Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e policisë së Republikës së Kosovës"*, ndërsa mbi këtë bazë të specifikuar më lartë mund të nxjerrët konstatimi se edhe Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës sa i përket beneficioneve, duke përfshi realizimin e shujtës ditore, paga mujore ekuivalente me pagën e rregullt (shpërblim) në fund të vitit siç njihet si paga e trembëdhjetë si dhe shtesa në pagë për kualifikimin shkollorë të cilat kërkon ti realizoj për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021 është në kundërshtim me vetë ligjin e policisë sepse kjo çështje është e rregulluar me legjislacion sa i përket nëpunësve civil dhe se udhëzimi në të cilin thirret ankuesi ka të bëjë vetëm me zyrtarë policorë e jo edhe staf civil përkundër që në këtë udhëzim pa bazë ligjore janë potencuar edhe personeli i policisë në cilësi të stafit civil.

Po ashtu nëse i referohemi nenit 47 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës sa i përket pagave dhe kompensimeve tjera Kolegji konstaton se nëse shihet përmbajtja e paragrafit 1,2 dhe 5 të këtij neni mund të konstatohet se pagat dhe kompensimet tjera sipas këtij ligji i referohen vetëm zyrtarëve policor por jo edhe stafit civil të policisë dhe se nga këto dispozita të potencuara rezulton që edhe Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës kur parashih beneficione të ndryshme për stafin civil është në kundërshtim me vetë përmbajtjen e ligjit të policisë respektivisht nenin 47 paragrafi 4 në të cilin thuhet: *"4.pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj"*, andaj edhe mbi bazë të këtyre rrethanave nuk mund të zbatohet për nëpunësit civil brenda këtij institucioni pasi këto çështje janë të rregulluara specifikisht me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave ka konstatuar se, Policia e Kosovës edhe për kundër faktit se nuk është aprovuar kërkesa e datës 24.10.2017 nga Ministria e Financave, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës prapë në kundërshtim me nenin 47 para paragrafin 4 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, ka nxjerrë

Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 23 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcakton se: *"1. Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për shtesat mbi pagën bazë në institucionin përkatës. 2. Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shumta e përgjithshme e shtesave dhe pagave bazë të jetë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës"*, dhe nenin 23 *"Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën buxhetore të nevojshme për kompensimin dhe pagesat e tjera për institucionin përkatës"*, që në rastin konkret Policia e Kosovës, mbi këtë bazë nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ka ekzistuar miratimi i Ministrisë përgjegjëse për nxjerrje dhe zbatim të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sa i përket planifikimit buxhetor, andaj edhe pretendimet e ankuesit mbi bazë të dispozitave ligjore të specifikuar më lartë janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit realizimin e shujtës ditore, paga mujore ekuivalente me pagën e rregullt (shpërblim) në fund të vitit siç njihet si paga e trembëdhjetë si dhe shtesa në pagë për kualifikimin shkollorë të cilat kërkon ti realizoj për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, Kolegji konstaton se janë tërësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe nenit 20 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, nga se me asnjë dispozitë ligjore që rregullojnë shërbimin civil nuk parashihen këto beneficione, po ashtu këto kërkesa janë të vjetruara edhe sikur kjo rregullore të prodhoj efekte juridike ndaj kësaj kategorie të nëpunësve civil nga se si kërkesa janë jashtë afateve ligjore të përcaktuara në dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"* e që në rastin konkretë kemi të bëjmë me pretendime ankimore që rrjedhin nga një Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës ndërsa kërkesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është bërë më datë 06.05.2021 që është jashtë çdo afati ligjor sa i përket kësaj natyre të çështjes.

Po ashtu, bazuar në dispozitën ligjore në fuqi gjegjësisht të nenit 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: *" Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj"*, i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, rrjedhimisht shfuqizohet çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, duke përfshirë edhe përmbajtjen e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që është nxjerrë në kundërshtim me këtë ligj sa i përket çështjes së të drejtave në raport me nëpunësit civil, ndërlidhur dhe me dispozitat transitore të nenin 83 për dispozitat transitore, të këtij ligji, ku përcakton se: *"1. Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin*

Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.389/2021, datë 02/06/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

